

## Emri i Lëndës : Hyrje në Gjuhësi

Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ELL 104	A	Pranverë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
<b>Lektori</b>	Arti Omeri, PhD						
<b>Asistenti</b>							
<b>Gjuha e kursit</b>	Anglisht						
<b>Niveli i lëndës</b>	Bachelor						
<b>Përshkrimi</b>	Ky kurs është një hyrje në teorinë dhe metodologjinë e linguistikës, që është studimi shkencor i gjuhës. Studentët do të mësojmë rreth degëve kryesore dhe aplikimeve të linguistikës -fonetikën, fonologjinë, morfologjinë, sintaksën dhe semantikën -duke eksploruar natyrën komplekse të gjuhës së njeriut nga perspektivat biologjike dhe shoqërore. Ne do ta shikojmë diturinë e gjuhës si një element të njoftes së njeriut, dhe do të zhvillojmë aftësitë e nevojshme për të analizuar dhe kuptuar të dhënat linguistike bazë.						
<b>Objektivat</b>	Sociolinguistika synon të studiojë efektet e përdorimit të gjuhës brenda shoqërive dhe efektet reciproke të organizimit shoqëror dhe konteksteve shoqërore në përdorimin e gjuhës.						
<b>Konceptet Kryesore</b>	-Fonemat -Fonologjia -Morfologjia -Sintaksa -Semantika -Pragmatika -Gjuha dhe Kultura						

## Programi i Lëndës

Java	Tema
<b>1</b>	Hyrje në disiplinën e gjuhësise: Çfarë është gjuhësia, pse e studiojmë atë? Çfarë është gjuha, aspektet e njoftes së një gjuhe dhe modaliteti gjuhësor.
<b>2</b>	Fonetika: Tingujt e gjuhës. Çfarë është fonetika, tingujt e të folurit, zanoret dhe bashkëtingëlloret angleze. Diskutimi i tingujve të të folurit në gjuhë të tjera dhe krahasimi me gjuhën tonë amtare. Fonetika e gjuhëve të shenjave.
<b>3</b>	Fonologjia: Çfarë është fonologjia dhe cilat janë disa rregulla fonologjike? Mësimi rreth fonemave dhe alofoneve. Si të zgjidhni problemet e fonologjisë?
<b>4</b>	Ushtime të zgjedhura nga Fonetika dhe Fonologjia
<b>5</b>	Morfologjia: Fjalët e gjuhës. Fjalët dhe formimi i fjalëve: Natyra e leksikut. Proseset morfoloqjike dhe llojet morfoloqjike të gjuhëve.
<b>6</b>	Sintaksa: Idetë themelore të sintaksës dhe vjetitë e saj. Konstituenca dhe kategoritë sintaksore. Vizatimi i strukturave dhe diskutimi i paqartësive të fjalive.
<b>7</b>	Morfologji dhe Sintaksë ushtime të zgjedhura
<b>8</b>	Provim Gjysmëfinal
<b>9</b>	Semantika: Një përbledhje e Semantikës dhe kuptimit të fjalëve. Diskutojmë rreth semantikës kompozicionale: Vendosja e kuptimeve.
<b>10</b>	Pragmatika: gjuha në kontekst dhe rregullat e bisedës. Nxjerrja e përfundimeve.
<b>11</b>	Ushtime të përzgjedhura nga Semantika dhe Pragmatika
<b>12</b>	Përvetësimi i gjuhës: Teoritë e përvetësimit të gjuhës. Përvetësimi i tingujve të të folurit, fonologjisë, morfologjisë, sintaksës dhe kuptimit të fjalës. Si të rriturit flasin me fëmijët e vegjël dhe përvetësimi i dy gjuhëve njëkohësisht.

<b>13</b>	Gjuha dhe shoqëria: Shumëgjuhësia shoqërore dhe huazimet në anglisht. Flasim rreth pidgins dhe creoles. Diskutojmë rreth rezikimit të gjuhës dhe vdekjes së gjuhës.
<b>14</b>	Prezantimi i projekteve të studentëve
<b>15</b>	Përsëritje dhe praktikë për provimin final
<b>16</b>	Provim Final
<b>Parakushtet</b>	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
<b>Literatura</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Dawson, H., &amp; Phelan, M. (2016). Language files: Materials for an introduction to language and linguistics,(12th edition), Columbus The Ohio State University Press</li> <li>Fromkin, V., Rodman, R., &amp; Hyams, N. (2013). An introduction to language, (10th edition), Cengage Learning.</li> </ul>
<b>Referenca të tjera</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Fasold, R. W., &amp; Connor-Linton, J. (Eds.). (2014). An introduction to language and linguistics. Cambridge University Press.</li> </ul>
<b>Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat</b>	
<b>1</b>	Studentët njihen me konceptet themelore të gjuhësisë
<b>2</b>	Studentët pajisjen me njohuritë bazë mbi disiplinat mikro - gjuhësore
<b>3</b>	Studentët ndërgjegjësohen mbi çështjet gjuhësore dhe zgjidhjen e ushtrimeve për çdo nëndisiplinë
<b>4</b>	Studentët fitojnë kompetencë dhe aftësi të plota në dallimin mes disiplinave
<b>5</b>	Studentët aftësohen në analizën dhe gjykimin e hollë në çështjet mikro - gjuhësore

### Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	40
Kuize	0	0
Projekte	0	0
Projekte semestrale	0	0
Punë laboratori	0	0
Pjesëmarrja në mësim	1	15
<b>Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final</b>	<b>55</b>	
<b>Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final</b>	<b>45</b>	
<b>Total</b>	<b>100</b>	

### Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	3	42
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	15	15
Provimi final	1	20	20
Të tjera	0	0	0
<b>Ngarkesa totale e orëve</b>			<b>125</b>
<b>Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)</b>			<b>5.00</b>
<b>ECTS</b>			<b>5.00</b>